



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1423/21

Nr. i fq. / Br. sh -02

Data: / Datum 08.12.2021

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Partecipim:08.12.2021

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe Thirrjes për Aplikim me nr. 30927/21 të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datë 01.07.2021

**MARRËVESHJE ME PARTICIPIM**  
**(Për projektin “Furnizim me Motokultivator me Frezë”)**

**E përpiluar në mes të:**

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi në njërën anë në cilësinë e subvencionuesit, dhe
2. Përfituesve të Motokultivatorve që kanë participuar për projektin “**Furnizim me Motokultivator me Frezë**”)

- Hysen Sfarqa, nga Studime e Poshtme me nr. personal: 1005298730
- Sabri Azemi, nga Vushtrri me nr. personal: 2004885727
- Bashkim Aliu nga fshati Stroc me nr. personal: 2005304787

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në sektorin e bujqësisë.

**Neni 2**

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfitueseve (Freza për Traktor) të Komunës, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfitueseve për realizimin e projektit **Furnizim me Motokultivator me Frezë** në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionues kryesor i projektit.

**Neni 3**

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfitueseve të **Furnizim me Motokultivator me Frezë** për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **7,500.00€**

#### Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **28,000.00€**, ndërkaq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **35,500.00€**

#### Neni 5

##### Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

#### Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

#### Neni 7

##### Obligimet e përfituesit

7.1 Përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej **150.00 €** për **Furnizim me Motokultivator me Frezë** në njëren llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.

7.2 Frezat në afat prej tri (3) viteve nga dita e nënshkrimit të kontratës janë aset i Komunës së Vushtrrisë, dhe si të tilla nuk mund të tjetërsohen shiten, dhurohen ose të epen me qira, në të kundërtën do të merren masa ligjore.

#### Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

### P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S

#### Investitori:

Komuna e Vushtrrisë

z. Ferit Idrizi



(Kryetar i Komunës)



#### Përfaqësuesit e përfitueseve të “Furnizim me Motokultivator me Frezë”

1. Hysen Sfarqa

2. Sabri Azemi

3. Bashkim Aliu

  
  
